



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.219 dt.08.12.2000

**PER  
MIRATIMIN E SHITESES SË LIMITIT TË PËRDORIMIT TË  
TE ARDHURAVE PER BASHKINE E TIRANES PER VITIN 2000**

Këshilli i Bashkisë Tiranë, i mbledhur sot me dt.08.12.2000, pasi mori në shqyrtim relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Financës “Për miratimin e shtesës së limitit të përdorimit të të ardhurave për vitin 2000 dhe detajimin e tij sipas destinacioneve”, mbështetur në ligjin Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal”, ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë shtesën e limitit të përdorimit të të ardhurave në masën 16.000.000 lekë të detajuar si më poshtë :

1. Ndërmarrja e Kuartalleve	6.000.000 lekë
2. Ndërmarrja e Gjelbërimit	1.000.000 lekë
3. Ndërmarrja e Ndriçimit Elektrik Publik	2.500.000 lekë
4. Ndërmarrja e Rrugëve	1.500.000 lekë
5. Ndërmarrja e Përpunim Plehut	1.000.000 lekë
6. Aparati i Bashkisë	4.000.000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**LEONIDHA TOSKA**